



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK KAVAJË

VENDIM

NR. 01 DATË 23/01/2016

“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË LINJËS SI DHE ORARËVE PËR LINJEN
KAVAJË – LUZ I VOGËL – KAVAJË ”

Në mbledhjen e dates 18/01/2016, Keshilli Bashkiak Kavaje mori në shqyrtim Projekt - Vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publik, në zbatim neni 7 pika 6, neni 10 pika 1/ë dhe neni 32 pika d “Mbi detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak të ligjit Nr. 8652 date 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”: si dhe ligjit 8308 date 18/03/1998 “ Per Transportet Rrugor “ i ndryshuar sipas nenit 14 “Këshilli bashkiak, duke u mbështetur në nevojat e popullsisë për transportin qytetës, përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për këtë lloj transporti brenda juridiksionit të vet” si dhe sipas neni 15 i këtij ligji.

VENDOSI:

1. Të miratoje në parim linjen e transportit rrethqytetase. **Kavajë – Luz i Vogël – Kavajë.**
2. Të miratoje oraret për këtë linjë.
 - a) Nisja në orën 7⁰⁰ mbërritja 7³⁰
 - b) Ky orarë vazhdon deri në orën 20⁰⁰ (26 orare nisjesh vajtje - ardhje)
3. Të merren masat për ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e kesaj linje pranë Këshillit të qarkut Tiranë
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e Prëfëkturës Tiranë.

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

